



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCES**

Tiranë, më 18/09/2013

Sqarim për mediat lidhur me disa shkrime në lidhje me procedurat

hetimore të Autoritetit të Konkurrencës në tregun e telefonisë së lëvizshme

Gjatë ditëve të fundit në dy gazeta janë publikuar shkrime, të cilat kanë ngritur hije dyshimi mbi procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës.

Në interes të publikut sqarojmë se, Autoriteti i Konkurrencës zbaton procedurat hetimore të parashikuara në Ligjin “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, (i ndryshuar) dhe aktualisht është në fazën e procedurës së hetimit të thelluar sipas parashikimeve të nenit 43 të këtij Ligji.

Autoriteti i Konkurrencës i ka bërë transparente të gjitha etapat hetimore duke publikuar vendimet e procedurave hetimore, duke filluar që me vendimin Nr.258 , datë 21.12.2012, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e telefonisë celulare me pakicë”.

Autoriteti i Konkurrencës respekton të drejtën e medias për informimin e publikut dhe çdo lloj komenti lidhur me veprimtarinë e tij, por i shikon si spekulative, pa referenca ligjore ose faktike, insinuatat që synojnë të përdorin hapësirat mediatike për arritjen e qëllimeve të caktuara.

Autoriteti i Konkurrencës është i vendosur të zbatojë ligjin dhe vetëm ligjin, duke garantuar publikun se do të zbatojë pa ndikime të gjitha procedurat ligjore që parashikon legjislacioni në fushën e konkurrencës dhe do të shprehet me vendim pas dëgjimit të palës nën hetim.

Lidhur me sqarimet teknike të sjelljes së operatorëve në tregun përkatës, Autoriteti sqaron mediat se është në fazën e përfundimit të procedurave të hetimit të thelluar dhe qëndrimi përfundimtar i Komisionit të Konkurrencës do të publikohet sipas procedurave që parashikon Ligji.